



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1149/3 prot.

Tiranë, më 22. 11. 2023

V E N D I M

Nr. 238, datë 22. 11. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 227 Regj., datë 25.10.2023, që i përket ankuesit A. A., kundër Shoqërisë së Transportit Ajror *“Pegasus Airlines”*², me pretendimin diskriminimin *për shkak të aftësisë së kufizuar*³.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri⁴,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

A. A. ka parashtruar ndër të tjera në ankesë se: *“Për shkak të një ftese nga “Polis University” me bashkëpunim dhe financim të Erasmus+ dhe të Bashkimit Evropian, në kuadër të workshopit “Open Minds, Umeá 2023” me një grup prej 7 vetash (bashkë me mua) u nisa nga Tirana drejt Suedisë me anë të fluturimit me një ndalesë në Stamboll me linjën ajrore “Pegasus Airlines” me destinacion final Stokholm, Sweden.*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin Shoqëria ose Pegasus Airlines.

³ Referuar Librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, ankuesi rezulton se është invalid, i grupit të parë.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Për shkak të gjendjes shëndetësore, dhe aftësisë së kufizuar në lëvizje, jam përdorues i karriges me rrota. Në rastin konkret përdor karrige me rrota, elektrike.

Duke pasur parasysh këtë fakt, u sigurova që të vë në dijeni linjën ajrore më shumë se 48 orë në avancë për udhëtimin tim me mjetin ndihmës me bateri. Gjë të cilën e bëj sa herë fluturoj duke marrë me vete këtë karrige elektrike. (fluturoj rreth 2 deri në 3 herë në muaj për arsye profesionale).

Në rastin konkret, sapo u paraqitëm pranë check-in në Rinas filluan pyetjet për karrocën elektrike, edhe pse çdo informacion ishte deklaruar më herët konform kërkesave të linjës ajrore. Pasi u përgjigja të gjitha pyetjeve teknike në lidhje me mjetin lëvizës, dhe stafi ishte i kompletuar me informacionin e nevojshëm, u vendosen 'taget' e check-init si tek karroca edhe tek bagazhet. Dhe në kohën e duhur proceduam me hipjen në avion.

U asistova nga stafi i asistencës së aeroportit në Rinas, dhe u sistemova në ulësen e avionit, ndërkohë duke pasur një pamje të drejtpërdrejtë nga dritarja direkt mbi stafin e "rampit" që po punonte me vendosjen e bagazheve, si dhe të karrocës që do merrja me vete.

U sigurova që të filloj me telefon gjithë procesin e ngarkimit në avion të karrocës pasi këtë metodë e përdor shpesh për të mbrojtur veten në rast të një dëmtimi që mund ti bëhet karrocës gjatë ngarkim/shkarkimit nëpër aeroporte, çdo gjë shkoi mirë deri në këtë pikë. Karroca u sigurua dhe u ngarkua siç duhet nga stafi.

Në momentin para se avioni të fillonte shtytjen mbrapa për të shkuar në pistën e nisjes, më afrohen i gjithë stafi i stjuardesëve dhe më thonë, dhe citoj: "Kapiteni i fluturimit ka vendosur që pajisja juaj asistuese të mos vijë në këtë fluturim. Ju jeni i lirë të vazhdoni rrugëtimin në destinacion, por karroca elektrike do zbritet nga bagazhet." Në këtë çast, vë re që portat e bagazheve të avionit ishin hapur dhe karroca ishte zbritur nga avioni dhe po largohej nga stafi i aeroportit.

Kërkova arsyetim mbi këtë vendim të kapitenit, si dhe kërkova të bisedoj me kapitenin për të kuptuar arsyet e refuzimit që karroca të fluturojë me mua, por nuk mora asnjë përgjigje reale përveç një justifikimi nga njëra prej stjuardesave duke më thënë që karroca nuk lejohet për shkak të baterive që përmban. Justifikim ky komplet jo real dhe pa baza pasi bateritë që përmban karroca janë të prodhuara nga fabrika në mënyrë që të jenë të sigurt dhe të lejueshme me çdo lloj metode transporti, përfshirë edhe fluturimet kontinentale apo ndër-kontinentale. (Kjo vërtetohet jo vetëm nga dokumentacioni përkatës, por edhe në bazë të eksperiencave të shumta që kam duke fluturuar e duke marrë me vete këtë karrige me rrota.)

Pas këtij lajmërimi nga stafi i fluturimit, me patjetër që më duhej të vendosja zbritjen time nga avioni pasi nuk procedoja dot pa mjetin ndihmës në destinacion.

U procedua me zbritjen time nga avioni.

Pas gjithë kësaj, kontaktova me stafin e linjës që ende ndodhej në aeroport dhe kërkova arsyet e vërteta për këtë ngjarje, por nuk mora asnjë përgjigje ndihmuese.

As nuk mu ofrua dëmshpërblim, as nuk mu ofrua fjetja në hotel (do cilësohet më poshtë por bëhet fjalë për një fluturim në 02:45 a.m.) as nuk mu ofrua biletë tjetër alternative.

Pjesa tjetër e grupit u detyrua të vazhdojë fluturimin me shpresën se do ju bashkohem në ditët në vijim. Gjë e cila u bë e mundur pas blerjes së një bilete me shpenzime personale me linjën Austria Airlines. Kjo e fundit, për fat të mirë nuk kishte asnjë pretendim ekstrem siç ishin ato të linjës së mëparshme, dhe me këtë fluturim çdo gjë shkoi mirë.

Rregullat/ligjet ndërkombëtare që linja ajrore Pegasus Airlines ka thyer janë të shumtë, por ndër to mund të përmend: Rregulloren “Air Travel Accessibility for Passengers with Disabilities” përcaktuar nga “International Air Transport Association JATA” ose Rregullorja e Bashkimit Evropian: “Regulation (EC) No 1107/2006 of the European Parliament and of the Council of 5 July 2006 concerning the rights of disabled persons and persons with reduced mobility when travelling by air.” etj...”.

Në vijim, A. A., kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, si dhe ndër të tjera: “... të merren masat e mundshme përmes institucioneve përgjegjëse me indicien e Komisionerit që së pari: Kjo ngjarje të mos përsëritet më, të paktën përmes Aeroporteve dhe kompanive shqiptare, por edhe përmes kompanive jo shqiptare që kanë degë zyrtare në Shqipëri.

Së dyti: të krijohet mundësia për të më ofruar dëmshpërblim nga pala përgjegjëse për gjithë këtë situatë që kam kaluar...”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 33/3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44/2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, germa b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Neni 4 i LMD-së, përcakton se: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjerash personash, përbën diskriminim”.

Për të vlerësuar legjitimitetin e palës kundër të cilit drejtohet ankesa, Komisioneri do i referohet parashikimeve të bëra në nenet 24, 25 dhe 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kështu, në këtë kod përcaktohet përmbajtja e personit juridik: “24. Personat juridikë janë publikë dhe privatë. 25. Personat juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen. 26. Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji”.

Referuar parashikimeve të mësipërme, vlerësohet se “sektori publik” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore, ndërsa “sektori privat” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimeve të nenit 26, të Kodit Civil.

Sa më sipër, duke qenë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk kishte informacion sa i përket selisë së Shoqërisë së Transportit Ajror “Pegasus Airlines”, përmes shkresës Nr. 1149/1 prot., datë 30.10.2023 iu drejtua Autoritetit të Aviacionit Civil, duke i kërkuar:

- Informacion lidhur me mënyrën se si ofron shërbimin e saj kompania ajrore e fluturimit “Pegasus Airlines”. Cili është rregullimi ligjor për këtë?
- A është Pegasus Airlines një subjekt i regjistruar si operator shërbimi në Republikën e Shqipërisë? Nëse po, a ka një përfaqësi brenda territorit Shqiptar dhe ku ndodhet ajo?

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Autoriteti i Aviacionit Civil, përmes shkresës⁵ Nr. 2213/1 prot., datë 07.11.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...ju bëjmë me dije se kompania Pegasus Airlines është një kompani e licensuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i shtetit Turk dhe nuk është një subjekt i regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

Në kryerjen e veprimtarisë dhe shërbimit që ofron kjo kompani në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohet ndër të tjera, Ligjit Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në drejtim të të drejtave të pasagjerit, Udhëzimit të Ministrit Nr. 1, datë 26.02.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve” dhe Urdhrit të Ministrit Nr. 329, datë 22.12.2014 “Për miratimin e Rregullores “Për të drejtat e invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit”. Rekomandojmë që ankimuesi të paraqesë ankesën e tij, gjithashtu pranë Autoritetit të Aviacionit Civil në adresën elektronike Pax@acaa.al, për t’u trajtuar në kontekstin e të drejtave të pasagjerit të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të cituara më sipër”.

Ligji Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 154, ku parashikohet “Mohimi i hyrjes në bord, anulimi ose vonesat e gjata të fluturimeve”, citon se:

“1. Në rast mohimi të hyrjes në bord, anulimi ose vonesash të gjata të fluturimeve, e drejta e pasagjerëve për t’u kompensuar për ridrejtim, e drejta e tyre për ndihmë dhe kujdes përcaktohen me akt nënligjor, të miratuar nga ministri në përputhje me detyrimet ndërkombëtare e veçanërisht me marrëveshjen shumëpalëshe.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet pa cenuar të drejtat e tjera të pasagjerëve, të cilat rrjedhin nga një kontratë transporti ajror, sipas kapitullit XI të këtij Kodi.

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1149/2 prot., datë 09.11.2023.

3. AAC-ja është autoriteti përgjegjës për zbatimin e pikës 1 të këtij neni, për sa u përket fluturimeve nga aeroportet e vendosura në Republikën e Shqipërisë dhe fluturimeve nga një vend i tretë në këto aeroporte. AAC-ja merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar respektimin e të drejtave të pasagjerëve.

4. Në rast të cenimit të të drejtave të pasagjerëve, përveç masës së gjobës të parashikuar në këtë Kod, AAC-ja merr edhe masa të tjera, të cilat përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe në përputhje me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e konsumatorit”.

Në zbatim të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës ka miratuar Urdhrin Nr. 329, datë 22.12.2014 “Për miratimin e Rregullores “Për të drejtat e invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit”, në të cilin janë përcaktuar rregullat për mbrojtjen dhe për masat e asistencës të invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse që udhëtojnë nëpërmjet ajrit, me qëllimin për t’i mbrojtur nga diskriminimi dhe për të siguruar që ata marrin ndihmë.

Në nenin 15 të Urdhrit të sipërcituar është përcaktuar procedura e ankesave, ku theksohet se:

“1. Invalidët apo personat me aftësi të kufizuara lëvizëse, që konsiderojnë se kjo rregullore është shkelur, duhet të sjellin çështjen në vëmendjen e entit menaxhues ose në vëmendjen e transportuesit ajror në fjalë, sipas rastit.

2. Nëse invalidët apo personat me aftësi të kufizuara lëvizëse për ndonjë shkelje të pretenduar të kësaj rregulloreje, nuk janë të kënaqur me ankesën e bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni, ankesat mund t’i drejtohen Autoritetit të Aviacionit Civil, sipas nenit 14 (1), ose të çdo enti tjetër kompetent përcaktuar.

3. AAC, në kushtet e një organi të një shteti të ZPEA-së⁶ sipas përcaktimit të Marrëveshjes Shumëpalëshe, i cili merr një ankesë në lidhje me një çështje që rezulton nën përgjegjësinë e një organi të emëruar të një shteti tjetër anëtar të ZPEA-së sipas përcaktimit të Marrëveshjes Shumëpalëshe, duhet t’ia delegojë ankesën organit të atij shteti.

4. AAC duhet të marrë masa për të informuar invalidët apo personat me aftësi të kufizuara lëvizëse për të drejtat e tyre sipas kësaj rregullore dhe për mundësinë e ankesës në organin e caktuar.”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përmbushje të qëllimit të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, shqyrton ankesat që drejtohen kundër autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë.

⁶ Referuar Ligjit Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, ZPEA është Zona e Përbashkët Evropiane e Aviacionit, siç është përcaktuar në marrëveshjen shumëpalëshe

Duke qenë se Kompania Pegasus Airlines, mbështetur në informacionin e administruar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, rezulton se është një kompani e licencuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil Turk dhe nuk është subjekt i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, si dhe ka selinë e saj në shtetin Turk, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kompetencë në shqyrtimin e ankesës në fjalë. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, duke qenë se subjekti ndaj të cilit është drejtuar ankesa, i përket një shteti të huaj dhe është nën përgjegjësinë e një organi të emëruar të një shteti tjetër anëtar të ZPEA-së, është Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili ka kompetencë t'ia delegojë ankesën organit të atij shteti, në rastin konkret organeve përkatëse të Aviacionit Civil Turk.

Për sa më sipër, bazuar në dispozitat e cituara më lart dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, rezulton se, Shoqëria e Transportit Ajror Pegasus Airlines, nuk legjitimohen si subjekt kundër të cilit mund të paraqitet ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ... b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon subjektin ankues t'i drejtohet me ankesë Autoritetit të Aviacionit Civil në adresën elektronike Pax@acaa.al, për t'u trajtuar në kontekstin e të drejtave të pasagjerit të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të në fuqi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja b), nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 227, datë 25.10.2023, të paraqitur nga A. A., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)